

STEBLEVA



GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.32. Shkurt 2016.

Çmimi 50 lekë.

SHTROHET TRASEJA E RRUGËS FUSHË STUDEN STEBLEVË VAKËF

KËRKESE

BASHKISË LIBRAZH
Për disa probleme të
dala nga mbledhja e
Shoqatës që kërkojnë
vëmendje nga ana juaj


Kërkohej që në territorin e fshatit Steblevë të mos bëhet asnjë veprim pa u konsultuar me përfaqësinë e Shoqatës, për problemet e fushes së investimeve nga jashtë komunitetit steblevas ose për çdo lloj veprimtarie tjetër. Mbështesim afatin 10 vjeçar për mosprekjen e pyjeve. Pyjet të jenë të paprekura sic i ka ruajtur vetë komuniteti nën drejtimin e shoqatës.

Të mos lejohet asnjë nga jashtë komunitetit të shfrytëzojë kullotat për blegtori e bletari. Bimët mjeksore të të gjitha llojeve të grumbullohen vetëm nga banorët e fshatit. Mbështesim plotësisht moratoriumin për gjuetinë. Brenda ligjeve kërkojmë të zgjerohet vija e verdhë e fshatit, mbi rrugën nacionale. Uji që na ka marrë ish-Komuna Ostren tek përroi i govatave, ti rikthehet zonës që i takon për nevojat e domosdoshme për tokat e Kutles. Në territorin ku është marrë uji është dëmtuar rëndë ekosistemi dhe nuk rrjedh asnjë pikë ujë, dhe nuk ka leje mjedisi dhe leje nga komuniteti.

Territori i Steblevës është ruajtur dhe do të ruhet sipas tavisë së trashëguar nga të parët tanë (datë 15.05.1937). Nuk lejojmë prekjen e saj.

Kërkojmë hapjen e pikës kufitare tek piramida 30 (Fusha e Llakavices)

Tokat në Steblevë të shfrytëzohen dhe të jepen me qera vetëm për steblevasit. Tek shkolla e fshatit të na jepet leje për ngritjen e një muzeu, duke na ndihmuar me ndonjë fond, si dhe hapjen e një zyre për shoqatën. **Kërkojmë asfaltimin e rrugës deri tek fusha e piramidës 30.** (Vijon në faqen 2)



U RINDËRTUA KISHA "SHËN NIKOLLA", STEBLEVË

FAQE 2



FALENDERIM

Falenderojmë Z. Sokrat Zorba për sponsorizimin e numrit 32 të gazetës "Stebleva"

Në këtë numër
do të lexoni

STEBLEVA, NJË
MREKULLI E FSHEHUR
TURISTIKE,
SHKRIMI I GAZETËS
"DITA", DATË 14
SHKURT 2016

FAQE 3

VËLLEZËRIT
MILLADINOV DHE
ORIGJINA E TYRE NGA
STEBLEVA

Nga Esat Musliu
FAQE 5

PENA E POETIT ELLIOTT
MOGLICA, NGA MOGLICA
E DIBRËS, KONTRIBUON
NË SJELLJEN E
NDRYSHIMEVE POZITIVE
NË POLITIKËN KANADEZE

Nga Halil RAMA

FAQE 3

LIMAN BAÇA NGA
SEBISHTI,
NJERKU I QEMAL
ATATURKUT

Nga Pavli NIKOLLA
FAQE 6

MJESHTRI I MADH I
NDËRTIMIT
PETRUSH ZORBA

F. Marku, M. Shutku, S. Zorba

FAQE 7

FATMIR BRAZHDA:
STEBLEVA MUNDËSI
SHUMË E MIRË PËR
ZHVILLIMIN E
EKOTURIZMIT MALOR

FAQE 8

**MOBILERI
AJAX**

Fasioni, kurajo, sakrificë, këto janë vlerat që inspiron në krijimin e Mobilitetit "AJAX". Rezultatet e kënaqshme filiare çuan shumë shpejt në konsolidimin e këtij realiteti komercial. Koha dhe eksperiencia i kanë treguar firmës cilat janë nevojat reale të klienteles kundrejt produkteve: cilesi e bukuri.

Zgjerimi i showroom-it në ambientet e godines në autostradën Tiranë - Durrës, një strukturë me një sipërfaqe prej 2300 m² e inaguruar në vitin 2006 i pengojt pikërisht kërkesave dhe shtimit të tipologjive të arredimit për çdo ambient shtëpiak.


Për t'i shtuar suksesit - sukses, biznesit - biznes, Mobiliteti "AJAX" ka zgjedhur po ashtu partnere të suksesshem.

Autostrada Tiranë-Durrës km 7, Tiranë, Albania, Tel: 042 406 601, Fax: 048 301 757, Cel: 068 20 67 602, info@mobileriajax.al

**Agjensia Funerale
"UNIVERS"**

Gëzim Rade
Cel: 06820 03 441
0695 33333 7

Adresa: Rr. "Bardhyl"
pranë Minibashkisë. Nr. 4



KËRKESË

Për disa probleme të dala nga mbledhja e Shoqatës "Stebleva" që kërkojnë vëmendje nga ana juaj

Vijon nga faqja 1

Lagjia e Katundit (Soskamalla) vuan nga mungesa e ujit të pishëm dhe për vaditje. Per problemin e vaditjes së tokave është e domosdoshme ndërhyrja e juaj për disiplinimin e këtij problemi. Shtyllat e tenzonit të lartë dhe

të ulët janë të deformuara të gjitha dhe përbëjnë rrezikshmëri të lartë, gjithashtu ka dhe ndërprerje energjie. Kërkohet rregullimi i tyre pa ardhur dimri e dëbora. Mundësimi i rregullimit të urave këmbësore brenda fshatit, ku një pjesë janë plotësisht jashtë funksionit.

Zalli i Stebleves është i pasur me peshq, dhe është i nevojshëm pastrimi i tij nga shelgjet mbasi ka 30 vjet pa vënë dorë. **Shoqata STEBLEVA është e vetmja shoqatë zyrtare e zonës, që ka mbrojtur dhe mbron interesat e komunitetit,** me një antarësi prej 4800 anëtarësh ku 400

prej tyre banojnë në fshat dhe jetojnë me burimet e të ardhurat nga resurset e fshatit. Planin e studimit urbanistik të territorit të Stebleves, shoqata merr përsipër ta realizojë me studio ose grup studentësh të arkitekturës. Nga ana juaj kërkojmë të na ndihmoni për shpenzimet e akomodimit të

tyre me një fond prej 200-300 mijë lek të reja, dhe projekti të kalojë për miratim në Këshillin Bashkiak. Lidhur me këto kërkesa jemi në pritje të reagimit konkret tuajin.

**KRYETARI SHOQATES
STEBLEVA
Mersin Hoxha**

SHTROHET TRASEJA E RRUGËS FUSHË STUDEN STEBLEVË VAKËF (SË SHPEJTI DO TË FILLOJË ASFALTIMI I SAJ)

Stebleva tashmë ka rrugën e saj. Ajo nuk varet nga drejtimi i rrugës nacionale, por ka rrugën e vet nga Fushë Studen në Steblevë dhe deri tek Vakëfi, ku bëhen festimet e mëdha të festës së pranverës. Steblevasit kërkojnë që kjo rrugë të vazhdojë deri tek piramida 30, ku së shpejti do të hapet pika kufitare doganore për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave të lehta.

Rruga është e shtruar

mirë, me cilësi të lartë. Ajo është ndërtuar nën kujdesin e deputetit të zonës Taulant Balla dhe të ministrit të financave, deputetit Shkëlqim Cani. Firma e ndërtimit Victoria Invest me president Z. Fatmir Kuci po bëhet gati edhe për asfaltimin e këtij segmenti. Ndërtimi dhe asfaltimi i kësaj rruge do të ndihmojë shumë për zhvillimin e turizmit në këtë zonë dhe në këtë fshat të bukur turistik.



U RINDËRTUA KISHA "SHËN NIKOLLA", STEBLEVË

Tradita e bukur vazhdon, bashkjetesa fetare mbizotëron. Stebleva jonë mbetet një nga shumë shembuj të këtij fakti shumë domethënës.

Historia është e shkruar, lum ai që di ta lexojë. Stebleva me tradita të veçanta, me hyrje dalje si në vëllazëri tek njëri-tjetri (orthodoksë e myslimanë) me festime të përbashkëta, me zemër e derë të hapur edhe këtë rrugë dhe tha fjalën e vet me vepra.

Përpara 4 vjetëve filloi rindërtimi i xhamisë së fshatit dhe pa asnjë dyshim që sponsorët ishin kryesisht bashkëfshatarët myslimanë, por asnjëherë nuk munguan edhe orthodoksit e fshatit.

Dhe xhamia u rindërtua e bukur dhe shumë e pëlqyer nga ata që e ndërtuan por edhe nga turistët e huaj, pasi ndodhet në mes të fshatit në një pozicion shumë të bukur.

Më 16 tetor 2015 i erdhi rradha edhe fillimit të rindërtimit të kishës së fshatit "Shën Nikolla", ku pasi u zbuluan themelet e vjetra filloi ndërtimi.

U bë inaugurimi i fillimit të punimeve në prani të bashkëfshatarëve tanë dhe të vëllezërve donator të ardhur nga Bullgaria.

Puna filloi dhe për çdo ditë ngriheshin muret e këtij objekti në të cilin punonin djemtë steblevas me brigadierin Reshat Gruda.

Me gjithë zemër i urojmë "Ju lumshin duart, ju Reshat, Zamir Murati dhe Shaban Kurti", se puna juaj është për marshalla dhe me 20 nëntor ju i vutë brezin e betonit atij objekti kaq të bukur, që ndodhet në themelet e veta, në truallin e tij, në fshatin e vet me këta njerëz kaq të mirë.

Çdo ditë tek kisha vinin dhe uronin bashkëfshatarët miq dhe dashamirës, jua donte zemra dhe të pinin nga një gotë verë sëbashku me këta djem duar artë.

Erdhi Mersin Hoxha, kryetari i Shoqatës "STE-

BLEVA" dhe pas urimit për punën e mrekullueshme ju tha:

"Po po do vazhdojmë edhe me objekte të tjera të cilët lartësojnë vlerat e fshatit tonë turistik"

E disa ditë më vonë u ul dhe bisedonte me Ledi Milloshin, përgjegjës i një agjencie turistike për të përgatitur një guide turistike me këto vlera që ka fshati Steblevë, pasi Stebleva është brenda parkut nacional "Shtebenik - Jabllonicë" me pyje, kullota të ruajtura shumë mirë.

Një ditë tjetër erdhi dhe Jashar Bajra dhe pasi i uroi punë të mbarë këtyre djemve na u drejtua mua dhe z. Haxhi Pirushi duke thënë :

Kjo punë është me shumë vlera. Ju faleminderit dhe ta gëzojmë së bashku" dhe shishet e verës u shpërndanë me të gjithë punëtorët, duke na kërkuar të bënim edhe nga një foto si kujtim.

Dhe here pas here vinin dhe ndalonin bashkëfshatarë të ky objekt dhe uronin ta gëzojmë sëbashku.

Stebleva sot numëron mbi 33 shtëpi të rindërtuara nga e para, ka edhe ndërtime kampion që së bashku mund të akomodojnë mbi 30 turistë në natë me komoditete shumë të mira dhe të kohës. Ky është vetëm fillimi pasi Stebleva është djegur 3 herë gjatë historisë me 1913, 1915, 1920 dhe është rindërtuar perseri nga mjeshtrat tanë duar artë.

Të katërtën herë fshatarët tanë erdhën në Tiranë, Durrës, Elbasan pas viteve 90' për një jetë më të mirë dhe ndërtuan "Steblevën" të "Kodra e Priftit", në Allias, Ali Demi, u ingranuan me jetën e kryeqytetit si të gjithë kuptohet me ndërtime shumë cilësore dhe me një dëshirë që çdo familje ta kishte së paku një nga fëmijët në Universitet për tu future në jetën e metropolit tonë.

Por në të njëjtën kohë nuk harruan se "Kryeqyteti"



i Gollobordës ishte STEBLEVA dhe ja pas 3-4 vjetësh u rindërtuan 33 shtëpi të reja.

Fati na ndjek vazhdimisht se të tillë njerëz ka Stebleva. Në gusht 2015 filon rikonstruksioni i rrugës nga "Meshtekna" (Fushë Studen deri tek "Vakafi" Steblevë me një gjatësi 7 km.

E pas 1 viti bëhemi me rrugë të asfaltuar, bëhemi të lakmuar, na shtohen punët, na shtohen sakrificat, turizmi kërkon punë dhe ne së bashku duhet t'ja dalim mbanë. Rindërtimi i kishës "Shën Nikolla", do të pasohet edhe me restaurimin e Manastirit në "MARKO DOBICA" ose siç i thonë steblevasit "Ballkoni i Steblevës" e duke u shpallur "Monument Kulture".

Prandaj për ne çdo vit ka punë dhe detyra, dhe me gjithë zemër urojmë njëri-tjetrit sa më shumë gëzime dhe lumturi në familjet tona.

Trifon Cfaruku



Shkrimi i gazetës “Dita”, datë 14 shkurt 2016



Pena e poetit Elliott Moglica, nga Moglica e Dibrës,

kontribuon në sjelljen e ndryshimeve pozitive në politikën kanadeze

NGA HALIL RAMA

Poeti Elliott Moglica, me origjinë shqiptare, prej vitësh ka qenë mbështetësi i flaktë i Justin Trudeau-t për zgjedhjen e Tij si Kryetar i Partisë Liberale Kanadeze (partia qendrore kanadeze). Gjatë zgjedhjeve Liberale për Leadership, Elliott Moglica kontribuoi me numurin me të madh të mbështetësve. Po ashtu, nga fillimi i vitit 2012 deri në shtatorin të 2015-s, Elliott-i, e përdori edhe penën e tij poetike duke kompozuar dhe botuar dy libra poetikë dedikuar Justin-it. Libri i parë u bë publik në mars të vitin 2014, i titulluar Burri i Protontë: Justin Trudeau (në anglisht) “The Proton Man: Justin Trudeau”. Kjo vepër mjeshtrore artistike është një poemë klasike me katër-kapituj (canto) multi-style dhe ka githsej 1,215 linjat e vargut, që motivon Kanadanë për Kryeministrin e saj të ardhshëm. Shkrimtari Moglica nuk pushoi së mbështeturi dhe shkruari për Justin-in. Në pranverë të vitin 2014 ai nisi kompozimin edhe të vëllimit të dytë. Ndërsa vazhdoi studimin e tij artistik dhe kërkues rreth “Poezia dhe Politika” (Poetry & Politics) – Moglica vazhdoi ta përdorë fuqinë e poezisë në perfeksionimin e politikës. Vëllimi i dytë u bë publik në shtator të 2015-ës. Duhet theksuar se të dy vëllimet kanë një mbështetje tepër të madhe në Tëitër.

Duke i shqyrtuar me kujdes dhe përmbledhur dy librat e fundit, “The Proton Man: Justin Trudeau” dhe “The Protonic Guardian: Justin Trudeau”, mund të them me bindje se Elliott Moglica e ka treguar veten si një penë e fuqishme e tipit shekspirian. Elliott-i po kthen “politikën helmuse” në “politikën pozitive”, duke luftuar me dritën, mençurinë dhe penën për ta

bërë botën një vend më të lumtur, të drejtë e të lirë. Me 24 tetor 2015, Zonja Katie Telford, Bashkë-kryetare e Fushatës Kombëtare të Partisë Liberale të Kanadasë (“National Campaign Co-Chair, the Liberal Party of Canada”), i shkruan Elliott Moglicës në “Tëitër” (përkthim) “... Faleminderit Elliott! Juve na keni mbajtur neve të gjithëve të inspiruar dhe me buzëqeshje për tre vite me radhë”.

Po ashtu, duke iu referuar faqes publike në “Facebook” të Elliott Moglicës gjejmë edhe një citim të Justin Trudeau-t (në vitin 2014-të) i cili shpreh respektin e tij për poetin Elliott Moglica: (përkthim) “Për Elliott-in/ Superstarin im i preferuar!!” (në anglisht) “For Elliott/ My favorite superstar!!”. Me 19 tetor 2015 Kanadaja sjell në fuqi partinë Liberale Kanadeze me një maxhoritet të fortë e udhëhequr nga Justin Trudeau. Partia Liberale Kanadeze, nga vendi i tretë, kthehet në fuqi pas rreth 10 vitësh. Si përfundim, me 4 nëntor 2015, shkëlqesia e Tij Justin Trudeau betohet në postin e Kryeministrit të 23-të i Kanadasë. Megjithatë, poeti Elliott Moglica do të mbetet në historinë Kanadeze jo vetëm si mbështetësi më i fuqishëm dhe besur i Tij, por edhe poeti i tij motivues.

Me plot goje dua të shtoj se të dy librat e fundit të Elliott-it duhet të futen në çdo bibliotekë univesitare dhe publike. Elliott Moglica, shtetas kanadez me origjinë shqiptare, është një poet entuziast, novelist, biograf, mësues anglishtje, eseist, gazetar i pavarur, interpretues, përkthyes (në tre gjuhë: anglisht, turqisht dhe shqip) dhe aktivist i lirive dhe të drejtave të njeriut. E. Moglica ka studiuar për rreth 24 vite në universitetet dhe

Maqedoninë, e bën Steblevën një zonë malore turistike, vetëm 30 min larg nga Struga. Mungesa e rrugës ka bërë që në dimër kjo zonë në këmbët e parkut kombëtar Shebenik-Jabllanicë të jetë një pamje e paarritshme për të gjithë ata që duan të shijojnë natyrën dimërore, për të mos udhëtuar shumë drejt veri-lindjes apo drejt Maqedonisë. Stebleva është një teatër natyror, një gërshetim i mahnitshëm i lëndinave, pyjeve, kodrinave, maleve dhe lumenjve. “Maja e Zezë”, e cila ndodhet në lartësinë 2225 m mbi nivelin e detit, është maja më e lartë në këtë zonë. I dyti renditet mali i Raduçit, me një lartësi 2084 m, i cili shtrihet në lindje të Steblevës.

Stebleva përshkohet nga përrenj dhe kroje të shumta, të cilët pasi grupohen formojnë lumin Zallë i Steblevës që përshkon rrugën Borovë – Trebisht – Okshitun, në Gjoricë të Dibrës dhe më tej bashkohet me Drinin e Zi. Krahas bukurisë, floqës dhe faunës së pasur, ky lumë karakterizohet edhe nga cilësia parësore e peshkut që rritet në këto ujëra, trofta me pika të kuqe.

Të mahnitshme janë pllajet dhe lëndinat e Visharicës, malit të Kallkanit e Mllacit, të cilat përbëjnë një nga pjesët më tërheqëse të Steblevës, të përshtatshme për aktivitetet sportive gjatë muajve të verës dhe pistat natyrore për ski, gjatë sezonit të dimrit.

Elliott Moglica



The Proton Man: Justin Trudeau

POETRY

akademitë më në zë në tre kontinente. Ai ka përfunduar studimet në Bachelor për Shkenca Ushtarake me rezultate të shkëlqyera. Ka shkruar tezën ushtarake: “Motivimi një pjesë të potencialin e fuqive ushtarake.” Moglica është diplomuar në ligjë dhe siguri (specializuar në Dogana dhe Emigracion) me Çmimin “Dijetari i Niagarës” dhe “Nderin e Presidentit”. Më pas, ai mbaroi studimet pasuniversitare në Mësimdhënie e Gjuhës Angleze (si gjuhë e dytë) me ‘Honours’ në Niagara College, Ontario, Kanada. I etur për dije, ai mban edhe

mjaft diploma dhe certifikate profesionale të tjera (në katër gjuhë: anglisht, shqip, turqisht dhe frengjisht). Kohët e fundit ai kreu studimet për Shkrimin Krijues në Universitetin e Kembrixhit në Angli. Gjatë kohës së studimeve në Britani poeti shkroi pjesën thelbësore të vëllimit të dytë poetik që i dedikohet Justin Trudeau-t, i sapo zgjedhur Kryeministri i Kanadasë. Ky vëllim titullohet, Gardiani Protonik: Justin Trudeau (në anglisht) “The Protonic Guardian: Justin Trudeau”.

Guardiani Protonik – historia e Justin Trudeau

Guardiani Protonik: Justin Trudeau, (anglisht) “The Protonic Guardian: Justin Trudeau”, është një baladë e shkruar nga Elliott Moglica. Poeti tregon historinë e dytë të Justin Trudeau-ut, një mësuesi të shkëlqyer kanadez, një deputeti të fuqishëm dhe një lideri protonik, politik dhe fisnik. Në tetëqind linjat e vargut, të ndarë në dy kapituj (‘cantos’), tensionet politike zhvillohen në betejat e vitit 2014 dhe 2015. Në mënyrë të përkryer, kjo poezi imagjinare i tregon lexuesit se çfarë po ndodhte duke përshkruar momentet e betejave midis “ushtrisë së kuajve” dhe kundërshtarëve të saj, “ushtria e mushkave” dhe “ushtria e gomarëve”. Lënda e kësaj balade merret me temën e psikologjisë politike. Kjo këngë, e ndërtuar mbi një zinxhir imagjinari, ka një karakter kryesor, Gardiani Protonik. Ai, (karakter i kryesor) lufton për të bashkuar njerëzit, por shumë karaktere imagjinare nxitojnë duke u përpjekur për të shkatërruar kërkimin e tij shpirtëror për “Unitet – Liberation – Lirive dhe të Drejtave të Njeriut”. Megjithatë, duhet të sillen në vëmendjen e lexuesit se kjo është e gjitha një krijim imagjinari. Ky vëllim, gjithashtu, përfshinë edhe “fjalorin e ri poetik dhe terminologjitë”, “Shënime fundore rreth baladës” dhe është ilustruar me shtatë vizatime nga autori. Nëpërmjet kësaj balade, Gardiani i Protontë: Justin Trudeau (“The Protonic Guardian: Justin Trudeau”), së bashku me vëllimin epik, Burri i Protontë: Justin Trudeau (“The Proton Man: Justin Trudeau”), poeti Moglica kompozon me mjeshtëri një total prej 2015 varje poetike. Të dyja librat së bashku kanë si tematike fuqinë e poezisë në përsosjen e politikës.

EMIGRANTËT GOLLOBORDAS NË SELANIK TË GREQISË DHE NDIHMA E ATATURKUT PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE TË TYRE

(SIPAS SHKRIMTARIT DIBRAN KËRSTO KOSTOV)

Emigrimi i dibranëve dhe steblevasve në Selanik është i hershëm. Edhe prindërit e Mustafa Qemal Ataturkut emigruan dekada më parë në Selanik. Me shtimin e numrit të emigrantëve janë shtuar edhe nevojat e problemeve. Emigrantët ekonomikë nga Dibra dhe Golloborda shtoheshin cdo vit. Cdo emigrant kur kthehej në vendlindje dhe më pas nisej për në Selanik merrte me vete edhe dy tre djem të rinj. Disa të tjerë që ishin stabilizuar atje kishin ndërtuar shtëpi për vete dhe për familjen. Por më pas shtoheshin problemet për shkollimin, punësimin dhe strehimin e fëmijëve.

Shkrimtari dibran Kërsto Kostov në librin e tij Debar i debarsko nis vekovite (Dibra dhe rrethinat ndër shekuj) tregon se fenomeni ekonomik i dibranëve dhe gollobordasve është shumë i hershëm. Në një stendë letrare në kishën Kirill e Medodi, e shkruar me germa greke, mund të kuptojmë se ata kanë patur esnafet e tyre në Selanik që nga viti 1817. Pra ata kanë emigruar që nga fundi i shek 18.

Besoje se të gjithë kemi dëgjuar për lagjen Pirgite, e cila për nga madhësia afrohej me qytetin e Selanikut të asaj kohe. Kjo lagje banohej me shumicë nga dibranë dhe gollobordas që përbënin mbi 200 fise.

Në një shkrim unë kam shkruar për mënyrën se si e zgjidhën ata problemin e kishës me ndihmën e njerikut të Ataturkut dhe vëllait të tij nga Sebishti. Edhe problem i shkollimit u hapi shumë problem dhe përsëri i ndihmoi Qemal Ataturku. **Ata kishin hapur më parë një shkollë ilegale në shtëpinë e një mësueseje nga Struga, e cila ishte vajza e Risto Milladinovit me origjinë nga Stebleva.**

Por në atë kohë zuri një epidemi që coi në mbylljen e shkollave. Me kalimin e epidemisë shkollat e tjera u rihapën, ndërsa kjo shkollë nuk u rihap sepse ishte pa leje.

Përveç lagjes Pirgite që u popullua së tepërmi u formua edhe një lagje tjetër me dibranë, ajo në Transvalle në afërsi të Gajtan Fabrikës. Në këto kushte hapja e shkollës u bë një nevojë e domosdoshme dhe urgjente. U vendos që në emër të kryefamiljarëve të lagjes të bëhej një kërkesë me shkrim e ti dërgohej Beledijes për miratim. Por në këtë kohë kjo kompetencë i kishte kaluar gjykatës. Kërkesa u nënshkrua nga të gjithë kryefamiljarët në turqisht dhe greqisht. Kërkesa u dorzua nga një përfaqësues i be-suar që ishte shkolluar në Greqi.

Një ditë në mëngjes përfaqësuesi i autorizuar shkoi tek dera e Konak Pasha dhe priti sa erdhi kryekomisari dhe valiu i qytetit. Pasi ata erdhën në zyrë kërkesa u dorëzua. Por çfarë ndodhi më pas! Të nesërmen në mbrëmjen vjen kryekomisari në kafenenë e lagjes ku mbledheshin banorët dhe



pyeti se kush e kishte dorzuar këtë arzuall. Përfaqësuesi i lagjes së dibranëve u përgjigj se e kishte ai.

Kryekomisari gjithë nerva u shpreh se shumë njerëz si puna jote vinë e ankohen, por ka vetëm një përgjigje Minderalltanda (.....) Shko edhe ti ku kanë shkuar të gjithë! Dhe bile shumë shpejt.

Jo zotëri, ndërhyri njëri nga të pranishmit. Ai urzua është kërkesa e qindra banorëve që kërkojnë të hapet shkollë në gjuhën e tyre. Ne i paguajmë taksa Padishahut dhe ai duhet të na japë të drejtat që na takojnë si gjithë të tjerëve.

Të nesërmen, i detyruar nga kërkesat e banorëve komisari filloi verifikimin e kërkesës, nëse është me firma të vërteta apo të fallsi-fikuara. Firmat dolën që të gjitha reale. Kur u pyetën njëri më njëri për nënshkrimet, vetëm dy vetë

të mencur që të shpjegonin para autoriteteve turke se nuk kishin të bënin me rebelim, por me një kërkesë normale për shkollim të fëmijëve. Njëri prej pleqve ishte Bllazhe Shaga nga Sebishti, të cilin komisarati e konsideronte njëri të vetin, por Bllazheja qëndroi si burrat duke thënë të vërtetën dhe duke mbrojtur kërkesat e bashkëqytetarëve të tij. Bllazheja takoi dy nënshkruesit e trembur dhe më pas shkoi në komisarati ku deklaroi se dy nënshkruesit ishin njerëz të mirë dhe se kërkesat e banorëve janë të drejta.

Një ndihmë të madhe për dibranët dhe gollobordasit në atë kohë dha Mustafa Qemal Ataturku që kishte mbaruar shkollën në Selanik, shkollën ushtarake në Manastir dhe më pas akademinë në Stamboll. Ai kishte gradën major dhe në atë kohë drejtonte një repart

statusi i internimit që trajtoheshin të gjithë dibranët dhe gollobordasit në atë kohë në Selanik.

Shkolla u hap dhe një kontribut të cmuar për ndërtimin e saj dhanë Petko Despotov nga Radoveshi dhe Stojan Bogov nga Vernica.

Puna, jeta dhe sakrificat e emigrantëve dibranë dhe gollobordas në përballimin e vështirësive janë pjesë e historisë sonë, të cilën duhet tua transmetojmë brezave.

Të shumtë kanë qenë inxhinjerët dhe njerëzit e shquar nga Golloborda që kanë shërbyer në të gjithë Perandorinë Turke, vecanërisht në vendet e Ballkanit, Greqi, Maqedoni, Bullgari etj.

Stojan Tanev Cvarikov nga Stebleva ka punuar disa vite në Ministrinë e Komunikacionit Grek. Ai ka projektuar dhe ndërtuar linja dhe ura hekurudhore, ka marrë titullin inxhinjer dhe i është akorduar medalja më e lartë e kohës Shpata e Artë.

Po kështu vëllezërit Alekso, Tane dhe Gjeorgji Mitrevski nga Sebishti kanë projektuar dhe ndërtuar kishën e Shën Gjergjit, një object me vlera të larta arkitektonike.

Gollobordasit nuk kanë qenë vetëm ndërtues të shquar, por edhe ushtarakë shumë të zotë. Në Selanik ka shërbyer si drejtues shtabi Dane Gruev nga Stebleva si dhe vëllezërit Dumani nga Sebishti. Viktor Dumani ka qenë Gjeneral dhe shef shtabi gjatë luftërave të viteve 1912/1913 në Greqi,



thanë se kishin nënshkruar pa ditur se çfarë kishin nënshkruar. Këta ishin V.Ushina dhe I.Ushina nga Klenja, të cilët ishin trembur nga presioni i administratës turke.

Firmëtarët e kërkesës, peticion u shpallën si rebelë, si njerëz që kërkojnë turbullira ndaj qeverisë. Për këtë u përzgjedhën dy pleq mbi 80 vjeç, pleq

ushtarak. Zgjedhi katër vullnetarë, i veshi me rroba ushtarake dhe i dërgoi tek Sulltanati për të kërkuar heqjen e Mocitolljes (Internimit) për dibranët sepse ishin dibranët dhe gollobordasit, ata që e kishin ndërtuar Selanikun. Ataturku i shpëtoi bashkëqytetarët e tij nga internimi në Dajar Bekir dhe nga

Strati Dumani ka qenë Admiral i Marinës Greke. Po kështu Gjorgji Stojan Bogov nga Vernica etj.

Emigrantëve u është dashur të bashkohen dhe të qëndrojnë të bashkuar, të formojnë esnafe dhe shoqata. Kryetari i parë i Vëllazërisë dibrane ka qenë Ilo Mazniku nga Vernica.

P. Nikolla



Nga Esat MUSLIU,
Regjizor

Ishte viti 1993. Shoqëruam grupin e parë të studentëve gollobordas që do të fillonin studimet në Rep. e Maqedonisë në Universitetin "Kirili dhe Metodi, në Shkup. Ishin vitet e para të demokracisë, ishte rivendosur komunikimi pas pesedhjetë vjetësh. Ishin hedhur pas mërite ideologjike dhe armiqsore midis dy shteteve fqinje dhe tani komunikoni si vëllezër me fqinjët tanë maqedonas. Republika e Maqedonisë ftonte studentë nga Shqipëria të studionin me bursë në universitetet e tyre.

Studentet tane, rreth 16, katër djem dhe dymbëdhjetë vajza, u sistemuan në fakultetet që zgjodhën vetë. Njeriu që iu përkushtua kësaj detyre të vështirë sepse viti shkollor kishte gati një muaj që kishte filluar ishte Zv. Ministri i Arsimit, Njazi Limanovski, me titull Profesor në histori dhe filologji, autor i shumë librave me karakter shkencor që e njhte shumë mirë gjuhën shqipe dhe historinë e Ballkanit. Kishte bërë ekspedita studimore në zonën e Gollobordës dhe kishte mbledhur folklor, histori, etnografi, arkeologji dhe studime të dokeve dhe zakoneve dhe kishte një simpati të veçantë për këtë krahinë.

Unë me shokët e mi, herë pas here shkonim në Shkup për të takuar studentët tanë dhe sigurisht takonim profesor Njaziun, derën e të cilit në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës e gjenim gjithmonë të hapur. Mirësjelljen e tij, përkujdesjen për fëmijët tanë nuk do ta harroj kurrë. (Ai ka mbi 10 vjet që ka vdekur).

Qëllonte që rrinim orë të tëra duke biseduar, meqë unë isha regjizor, ai interesohet të ballafaqonte njohuritë e tij me të mijat rreth historisë, folklorit, zbulimeve arkeologjike, jetës dhe bëmave të kësaj krahine.

-A e di ti se nga e ka origjinën Qemal Ataturku, udhëheqësi i madh që krijoi shtetin turk? - më pyeti një ditë.

Unë pa u menduar fare iu përgjigja: - Nga fshati im, Stebleva!, - dhe pa ngritur kokën vazhdova të shfletoj një libër të botuar prej tij.

- Është një fshat që ka nxjerrë figura historike të mëdha. Nga Stebleva e kanë origjinën jo vetëm burra shteti të mëdhej si Ataturku por edhe shumë të tjerë."

- E di, - i thashë. - Nga një fshat pranë nesh i cili quhet Zabzun, ka dalë një figurë tjetër e ndritur e historisë shqiptare, një tjetër Qemal...

Ai më pa me vëmendje.

VËLLEZËRIT MILLADINOV DHE ORIGJINA E TYRE NGA STEBLEVA

Qemal Stafa. Një hero i luftës nacional-clirimitare të Shqipërisë.

Të lutem historinë e familjes së Qemal Ataturkut ma shkruaj ashtu si e di ti.

Në takimin tjetër ia solla shkrimin me disa faqe. E lexoi dhe me kërkoi leje që ta botonte në një gazetë qëndrore, sigurisht me emrin tim si autor. U botua. Te nesermen me pritje me gazetën në duar.

- Është pritje me kureshtje të madhe, janë befasuar shumë historianë. Janë befasuar vecanërisht për faktet që sjell ti në historinë që shkruan. Ke hapur polemika.

-Nuk e kam sajuar unë - i thashë. - Është një histori që e tregojnë pleqte e mocëm të Steblevës. Ai nxori nga sirtari një ftesë dhe ma zgjati.

-Je i ftuar tek "Netët poetike të Strugës". Është një aktivitet botëror shumë i bukur. Në muajin korrik, për ditë dhe netë me rradhë poetë nga gjithë bota shkëmbejnë poezitë e tyre.

E pranova ftesën duke e falenderuar profesorin. Shkova në këtë festë. Vërtetë që ishte një festë e bukur e poezisë botërore. Në urën mbi Drin recitoheshin poezi në të gjithë gjuhët e botës, pesë ditë dhe netë, nën emblemen e Vëllezërve Milladinov.

Po kush ishin këta vëllezërit Milladinov? Pyeta një poet shqiptar që jetonte në Strugë. Më tha që janë nga figurat më të mëdha të rilindjes kulturore të Maqedonisë gjate pushtimit turk. Njëri është poet, tjetri ka hartuar fjalorin e gjuhës maqedone, ka bërë studime të folklorit, etnografisë, gramatikës... Janë sic kemi ne rilindasit, Vëllezërit Frashëri, Kanë jetuar në shekullin e XIX dhe janë nga Struga.

Nata e parë e Poetikës, u hap me poezitë e Konstandinit, vëllait të vogël poet. Ishte një spektakël i bukur, emocional. Aktorë të teatrit recituan poezitë e Kostandinit të vogël, vëllait të fundit nga gjashtë vëllezërit. (Mu kujtua Kostandini i Doruntinës). Kishte mbaruar gjimnazin "Zosimea" në Janinë. Fillova të mendoj se dhe Naim Frashëri ynë gjimnazin "Zosimea" kishte mbaruar. Ishte bashkëkohës, lindur në 1830, gjimnazin e ka kryer më 1849.

Ndoshta kanë qenë në një klasë me Naimin. Poezitë e Konstandinit i përshkonte malli, malli për vendlindjen, Strugën, liqenin, mjellmat dhe lejlekët, dhe veçanërisht për diellin, diellin e Strugës. "Tuga za Jug" (Malli për jugun). Edhe Naimi shkruante poemën "Bagëti e Bujqësi". Seç gjeta këtë mall të përbashkët të këtyre dy poetëve ballkanikë. Të dy vdiqën larg vendlindjes. Naimi në Stamboll, ndërsa Kostandini i helmuar nga agjentët turq në spitalin e burgut në Carigrad më 1862.

Dy ditë më vonë do të



Zv. Ministri i Arsimit, Njazi Limanovski, me titull Profesor në histori dhe filologji, autor i shumë librave me karakter shkencor që e njhte shumë mirë gjuhën shqipe dhe historinë e Ballkanit: "Mustafa Qemal Ataturku është nga Stebleva e Dibrës"

vdiste dhe vëllai i tij Dhimitri në burg, gjithashtu i helmuar si vëllai nga agjentët turq. Ishte koha kur popujt e ballkanit kishin filluar luftën për tu cliruar nga sundimi shekullor otoman.

U varrosën fshehurazi si të infektuar nga tifo, dhe varri i tyre nuk dihet. Ata ishin gjashtë vëllezër dhe dy motra. Baba i tyre Risto dhe nena Sulltana ishin të ardhur në Strugë rreth viteve 1800 në kohën e vilajeteve të mëdha. Pushtimi turk i lodhur dhe i dërmuar nga luftat po jepte shpirt. Fshataret të dërmuar nga taksat e rënda emigronin nëpër qytete. Kështu erdhi në Strugë edhe familja Milladinov. Vëllai i madh, Dhimitri (1810-1862) u shkollua në Ohër. Punoi dhe jetoi në Durrës për pesë vjet pranë një shoqërie tregtare italiane. Bashkë me vëllain e dytë Naumin pasi mbaruan gjimnazin e Janinës "Zosimea". Me tej punoi si mësues në Ohër dhe pati student poetin e famshëm Grigor Perliçev, autor i poemës "Skenderbeida", ndryshe quhet edhe si "Homeri" i dytë i Ballkanit. Ai e kujton shpesh Dhimitër Milladinovin, mësuesin, pedagogun e mrekullueshëm që me njohuri të gjera solli shumë ndryshime dhe rinovoi shkollën e Ohrit ku studionin edhe shumë nxënës shqiptarë. Këtu i shkruan Perliçevi në librin e tij "Autobiografi".

Dhimitri mblodhi dhe botoi në disa vëllime folklorin maqedon dhe hartoi "Fjalorin e Gjuhës Maqedone", vepra madhore që përdoren edhe sot.

Kur takova Njaziun më

pyeti: -Ishe te Netët poetike që mbajnë emrin Vëllezërit Milladinov?

- Po.- i thashë. Dhe i tregova për çfarë pashë.

-A e di se nga e kanë origjinën Vëllezërit Milladinov?

- Nga Struga...

- Prindërit e tyre janë të ardhur në Strugë.

- Po...u tha diçka e tillë, por vetëm kaq.

- Janë me origjinë nga Stebleva! Më pa në sy dhe pritje reagimin tim.

Unë mbeta gojë hapur.

-Stebleva si shumë fshatra të Gollobordës ka një popullsi të përzier, të krishterë dhe myslimane. Qyteti më i afërt për ju ka qenë Struga. Aty i bënit pazaret. Që aty udhëtonit për në Ballkan. Bënit edhe krushqi me fshatrat që janë rrotull Strugës. Ju keni njerëz në Strugë? - më pyeti.

-Po, i thashë, bile shumë. Me dy familje kam kontaktuar, edhe të tjerë bashkëfshatarë të mi., kanë farefis. Babai im ka patur një dyqan në Strugë, një ëmbëltore.

Ai më dëgjonte. Mori një bllok e hapi, e shfletoi disa faqe.

-Ju keni një lagje në Steblevë që quhet Sellska-malla.

-Po, i thashë. Duhet të jetë lagja më e hershme.

- Në fund të lagjes është një shtëpi e ulët ku banon një familje e krishterë me mbiemrin "Cota".

U mendova pak sa e gjeta për cilin e kishte fjalën. Ai më zgjati bllokun ku ishte planimetria e lagjes vuri gishtin në shtëpinë në fund.

-Këtu jetojnë pinjollët e fundit të vëllezërve Milladinov. Vëllai i madh u

shpërngul në Strugë, vëllai i vogël mbeti në Steblevë. Atje ai hapi një dyqan, kosaxhi.

Mu kujtua pinjollit i fundit i Cotajve, një djalosh zeshkan me flokë kaçurrela të zeza. Po e dëgjoja i nemitur. Njaziun nxorri nga një çantë një shishe verë. "Tuga za jug" (Malli për jugun). Në grykën e shishes si një medaljon i bukur varej një karton ku shkruhej diçka. Ishte një poezi:

-Është elegjia e Kostandinit Milladinovit "Malli për Jugun"... është perla e poezisë maqedone... e shkroi disa ditë përpara se te vdiste...para se ta helmonin turqit.

-Është vera më e mirë maqedone prandaj ka nderin të mbajë emrin e elegjisë më të bukur të poezisë sonë.

Po shëtitja me vajzën time dhe dhëndrin në sheshin e restauruar të Shkupit, sot, pas njëzet vjetësh. Ishte i mbushur me monumente të heronjve historik të kombit maqedonas. Njëra nga urat mund të quhej ura e artit dhe kulturës. Në të dy anët ishin vendosur monumente të korifejve të kulturës dhe artit të kombit. Në mes të urës ishte një monument madhështor i dy figurave intelektuale, njeri ulur me pendë në dorë, tjetri në këmbë me vështrim të hedhur larg. Në piedistal lexova; "Vëllezërit Milladinov, Dhimitër dhe Kostandin" Ndalova, ishin madhështorë...

Iu drejtova dhëndrit tim maqedon, ai shtrëngonte krahun e vajzës time.

I shikon këto dy vëllezër? Po, - tha ai - Janë vëllezërit Milladinov, krenaria e kulturës sonë.

Janë me origjinë nga fshati im, Stebleva e Dibrës.

Liman Baça nga Sebishti, njerku i Qemal Ataturkut

NGA PAVLI NIKOLLA

Steblevasit me krenari flasin e shkruajnë, madje organizojnë dhe aktivitetet të ndryshme në kujtim të burrave të mençur e patriot që kanë dalë nga fshati i tyre si Azis Lila, Vaid Kormaku etj.

Por ata kanë të drejtë të krenohen e të tregojnë historinë e një burri tjetër me prejardhje nga fshati i tyre e që la emër jo vetëm për Steblevën e Gollobordën por dhe më gjerë, për njeriun që reformoi shtetin e ri turk dhe e modernizoi atë, Mustafa Qemal Ataturkun. Ndoshta jo të gjithë e dinë se ai rrjedh nga familje e madhe e patriote e fshatit Steblevë.

Tregimet gojore të steblevasve kanë rënë në vesh të disa studjuesve e shkrimtarve që kanë studjuar e shkruar për trevën e Gollobordës si Prof.Dr.Milenko Filipoviç, Njazia Limanoski, Kërsko Kostov e ndonjë tjetër, të cilët kujtimet e tregimtarëve gojorë steblevas i kanë hedhur në letër dhe së bashku me studimet e tyre kanë shkruar gjithë historinë e këtij burri të shquar. Sipas këtyre shkrimtarëve ai vjen nga familja e Cenko Mustafës nga Stebleva, i cili ka qenë gjyshi i Kemal Ataturkut. Si shumë gollobordas edhe Cenko Mustafa ishte emigrant ekonomik në Selanik të Greqisë. Dihet që dibranët e shumica prej tyre gollobordas kanë qëndruar në Selanik sa kanë krijuar një lagje të tërë të tij, të quajtur "Pergite". Deri në vitin 1912 në Selanik kolonia e emigrantëve dibranë numëronte 12000 veta. Si të gjithë këta edhe Cenko Mustafa u stabilizua atje duke punuar si "korrës bari" (kosaç) dhe një herë në vit kthehej në Steblevë tek pjesa tjetër e familjes. Këtë ritual e bënte çdo vit. Sa herë që kthehej nga Stebleva për në Selanik ai merrte 3-4 djem të rinj dhe i ndihmonte që të sistemoheshin diku në punë që të fitonin dhe ata ndonjë parë për familjet e tyre. Punët që bënin atje ishin të ndryshme në fillim punonin si shitës ambulanti, duke shitur sheqerka, bozë etj. Por disa prej tyre hapnin edhe dyqane e restorante e bashkoheshin në esnafe.

Kjo vajtje-ardhje çdo vit nga Stebleva dhe anasjelltas kishte shumë shpenzime e lodhje, prandaj Cenko Mustafa vendosi që të marrë me vete bashkëshorten dhe dy djemtë e tij e të vendosej përfundimisht në Selanik. Kështu idenë e tij e bisedoi me pjesën tjetër të familjes dhe së bashku vendosën që të largohen nga fshati i tyre i lindjes.

Cenko Mustafa ishte



njëri i respektuar dhe e donin të gjithë. Para se të nisej për në Selanik ai vendosi të bënte një darkë lamtumire, ku ftoi miqtë e bashkëfshatarët e tij, por i porositi të mos këndonin se vendimin për tu larguar nga fshati e përjetoi me dhimbje e mall.

Miqtë e bashkëfshatarët e respektun Cenkon dhe i vajtën në darkën e lamtumirës. Pas dy tre ditësh ai mbledhi placat e paisjet më të nevojshme, i ngakoi në mushka dhe u nis për në Selanik. Atë e përcollën gjithë fshati, i madh e i vogël dhe i uruan gjithë të mirat për te dhe familjen e tij.

Tregojnë se në Selanik ai i rregulloi të dy djemt, u bëri shtëpi dhe i martoi të cilët lindën fëmijët e tyre (nipërit e Cenko Mustafës) njëri prej të cilëve ishte Kemal Ataturku.

Sipas shkrimtarit Kërsto Kostov, baba i Ataturkut punonte në një punishte duhani ku mori një sëmundje të rëndë dhe vdiq në moshë të re, duke lënë të birin (Kemalin) fare të vogël dhe bashkëshorten e tij vejtë, gjithashtu shumë të re.

Kërsto Kostov është me origjinë nga Erbeli i Maqellarës, por qysh i ri ka ikur emigrant në Sofie të Bullgarisë. Ka lindur në vitin 1897 dhe vdekur në vitin 1986. Në librin e tij "Debar i Debarsko niz vekovite" (Dibra dhe rrethinat ndër shekuj) e ka shkruar historinë e martesës së dytë të nënës Kemal Ataturk dhe ja si e përshkruan ai:

Siç u tha më sipër kolonia e emigrantëve dibranë u rrit shumë, kishin shumë problem për të zgjidhur, nuk kishin as shkollë për fëmijët e tyre as kishë ku të ushtronin

ritet e tyre fetare. Prandaj lindi nevoja e bashkimit të esnafeve të vegjël në një esnaf të madh të bashkuar. Kryetar i këtij esnafi u zgjodh Panajot L Lazarov nga fshati Zaborje dhe nga një pjestar për çdo fshat u zgjodh në këshillin e esnafit.

Kështu nga fshati Sebisht u zgjodh Blazhe Shaga, nga Stebleva Duko Çfarku e kështu me rradhë nga Klenja Todor Kuklev, nga Gjionveci Velo Lubikov, nga Trebishti Ivan Stojkov, nga Vernica Ilia Maznikov e kështu me rradhë për çdo fshat. Një nga objektivat kishin ndërtimin e një kishë. Kishin mbledhur 14.000 groshë dhe kërkonin leje nga qymeti. Pitrop u zhgjidh Ivan Peka nga Sebishti. Por hasën shumë vështirësi për të marrë leje ndërtimi.

Për të marrë lejen e ndërtimit një ndihmesë të madhe ka dhënë Liman Baça nga Sebishti i Gollobordës, orthodox i myslimanizuar, biznesmen i materialeve të ndërtimit dhe antarë i "Beledies" (antar i këshillit bashkiak) sidhe vëllai i tij Rexho Baça i cili u'a dha një shtëpi të tij orthodoxeve që ta bëjnë kishë me qera 400 grosh në vit. (Grosh-monedhë e asaj kohe).

Por Liman Baça është i përmendur për një arsye tjetër, për faktin që është baba i dytë të Kemal Ataturkut, njerku.

"E përmend emrin e Liman Baçës i myslimanizuar nga fshati Sebisht, Debarsko, sepse nuk mund të jetë pa interes po të tregojmë për këta shumvjeçarë në komunën e qytetit - (Beledia e Selanikut). **Ai është babai i dytë (njerku) i presidentit të Republikës Turke - Kemal Ataturk. Baba i Kemal Ataturkut**

ka punuar në një kompani duhani. Për shkak të një sëmundje të rëndë ka vdekur i ri. Gruaja i kishte mbetur vejtë me të voglin Kemal, i cili ka lindur në Selanik. Më vonë nëna e Kemalit është martuar me Liman Baçën, sipërmarrës ndërtimi dhe tregëtar i materialeve të ndërtimit. Ja nga vjen që Gazi Mustafa Kemal-pasha është nga Sebishti". (Kërsto Kostov faqe 133)

Me realizimin e kësaj martese vërtetohet jo vetëm prejardhja biologjike e Kemal Ataturkut nga Golloborda, por edhe nga martesat e dytë e nënës së tij ai përsëri ishte nga Golloborda. Shkrimtari që sapo cituam ka shkruar mjaft për emigrantët dibranë e gollobordas të cilët sipas tij në Selanik nuk kanë pasur konkurent. Kush kërkonte të ndërtonte shtëpi të re, nuk shkonte tek arkitektët, por pyeste: - Kush e ka ndërtuar këtë shtëpi? - Dhe shkonte tek ai ndërtues i thoshte se dua një shtëpi si kjo, bënte pazarin e në fund merte çelsat e shtëpisë.

"Në Carigrad, dibranë-specialistë nga Golloborda, kanë bërë punimet në oborrin e Ill-diz-Koshk-Dollma, për ndërtimin e të cilëve janë dekoruar me dekorata e medalje dhe privilegje të tjera të Perandorisë Turke. Ata ftoheshin në festime të ndryshme dhe ushtarake ku mbanin në gjoks dekoratat e tyre". (Kërsto Kostov faqe 134, Foto).

Tregimet e tij për jetën e punën e emigrantëve gollobordas janë të shumta por ne menduam të ndalemi në ato tregime që flasin për prejardhjen e Ataturkut, për të treguar jo vetëm se ai vjen nga Golloborda, por dhe historinë e tij si ka rrjedhur deri në ditët tona. Siç u tha dhe më sipër Liman Baça u bë baba i dytë i Ataturkut dhe si njëri i pasur që ishte nuk kurseu asgjë për rritjen e shkollimit e tij. Ataturku ishte i zgjuar nga natyra i prirë për artin ushtarak dhe Akademinë ushtarake e përfundoi me rezultate të larta. Familja e Ataturkut ka ikur nga Stebleva, por steblevasit nuk e kanë harruar. Ata gjithmonë e kujtojnë për birin e tyre.

Dihet që emigrantët gollobordas kanë punuar jo vetëm në Selanik të Greqisë, por edhe në shtete e qytete të tjera të botës. Ata me punën e tyre kanë lënë emër të mirë kudo që kanë punuar si në Stamboll, Izmir, Ankara etj. Po përmendim disa nga ndërtimet më në zë që janë bërë nga dibranët e gollobordasit. Ato janë: - xhami, shkolla e lartë (gjimnazi turk), shkolla për oficerët me konvikte, tre më të mëdhatë qen-

dra tregëtare në qendër të qytetit, shtëtitaren kryesore, "Shahin Razde-beg. Velo Gugush od sella Steblevo ka ndërtuar fabrikën e bojës më e madhja në qytet dhe 40 furra buke nga më modernet të asaj kohe. Tregohet që në rezidencën presidenciale punonin disa ustallarë nga Golloborda. Ata midis tyre flisni maqedonisht. Një ditë prej ditësh pa u ndjerë është shfaqur Kemal Ataturku. Ai me kujdes i ka studjuar puntorët, duke dëgjuar gjuhën që flisnin dhe bisedat midis tyre. Kur e panë puntorët e lanë punën dhe e përshëndetën.

"Nga jeni ju i ka pyetur ai?"

"Nga Golloborda i është përgjigjur puntori më i vjetër."

"Atje ka një fshat që quhet Steblevë? - Pyeti përsëri Ataturku."

"Po unë kam nga ai fshat u përgjigj njëri nga puntorët."

Ataturku e ka parë me kujdes dhe e ka pyetur përsëri:

"Ka ndonjë fshatar nga fshati yt që mban mbiemrin Mustafa?"

"Po, ka psur dikur. Ai ka qenë Cenko Mustafa, por para shumë vitesh ka emigruar në Selanik dhe që atëherë nuk ja kemi dëgjuar emrin. Në fshat sot e kësaj dite qëndrojnë rrethojat e shtëpisë së tij dhe ka një arrë (niva) të madhe e cila quhet "Cenkova Buka" - është përgjigjur puntori."

Pasi u mendua përsëri Ataturku i tha ustait:

"Kur të kthehesh në fshatin tënd Steblevë, o njeri i mirë, do tu thuash pleqërisë së fshatit. Nivata "Cenkova Buka t'ia japim ta punoj fshatari më i varfër, ndërsa shtëpia më e vjetër le të qëndroj, ndoshta do të vijë ndonjë ditë. Aq tha Ataturku dhe iku, por me gjithë dëshirën e madhe të tij për të vizituar fshatin e prejardhjes së tij nuk mundi ta realizojë. (njazia Limanska "Zburnik" faqe 30, foto).

Nazif Nura nga Stebleva tregon:

Kemi pasur shtëpinë afër themeleve të shtëpisë së vjetër të Cenko Mustafës. Kur po ndërtonin shtëpi të re, vajta të marr disa gurë për qoshe në muret e shtëpisë të Cenko Mustafës, babai që më pa më tha: Ktheji gurët e shtëpisë ku i more. Ajo është shtëpia e Cenko Mustafës. Gjyshi i Ataturkut ka lënë amanet që rrethojat e shtëpisë të mos i prekin. Në atë kohë Stebleva ndahej në dy Mëhalla "Leska Malla" dhe "Sellska Malla". Shtëpia e vjetër e Cenko Mustafës ishte në "Leska Malla".

Kështu e kanë përshkruar historinë e Kemal Ataturkut historianët, shkrimtarët e tregimtarët gojor.

Zorbova Tumba është kodra ku ka banuar fillimisht familja Zorba, por për arsye të shqetësimeve e sulmeve të keqbërësve, familja që merrej më shumë me blegtori se me bujqësi shpërngulet nga e keqja dhe zë vend në lagjen na Bordo ku banonin fiset Cvar-kovci, Gjinojci, Radinci, Rажkovci, Lilovci, Kitinci, Pulevci e shumë të tjerë. Stanko Zorba, babai i Petrushit martohet me Todor Cvarkun, motra e Orsan, Dojçin e Siljan Cvarkut. Nga çifti i ri u lind Petrushi. Këtu familja ishte më e qetë, e rrethuar nga bashkëfshatarë. Këtu Petrushi kaloi fëmijërinë dhe rininë e hershme, bridhte e lodronte me bashkëmoshatarët e fqinjëve. Kënaqësi të madhe kishin veçanërisht në dimër pasi rrëshqisnin me ski ashtu si dhe djemtë më të rritur. Si bashkëmoshatarët kulloste qingjat rreth fshatit dhe shijonte bukuritë e natyrës së mrekullueshme të fshatit që është i pasur me burime e ujra, pyje ahu të pafund, e lisa, livadhe të shumta që në krye kanë nga një burim uji siç do të thoshte më vonë i biri i Petrushit, Cvetani.

Më vonë kullot një tufë delesh të familjes si shumë të tjerë në këtë fshat blektoral. I kisha delet e mira, dhe për këtë më përgëzonin shokët. Kisha edhe Sharkon (qenin) që ishte më i miri nga të tjerët, - thoshte Petro. Një ditë daja, Orsani më thotë: "Na e jep atë delen e shëndoshë ta pjekim.

-Jo, -i thashë, - të pyes nënën. Daja nuk i tha gjë, por ditën tjetër kur shkon në shtëpi i numëron delet si zakonisht dhe nuk e sheh delen që i kërkoi daja. I thashë nënës e cila nuk u shqetësua. Ajo më tha se duhet të jëtë ngatërruar me ndonjë tufë tjetër. Në mbrëmje vonë, dajë Orsani i ftoi për darkë të gjithë. E ëma i thotë djalit: "Mos u mertzit se delen e ka marrë daja. Por të shkojmë edhe ne të darkojmë me ta."

Në moshën 30-vjecare martohet me Donka Popën, një vajzë nga Jabllanica, e bija e Milenko dhe Elena Poposka. Milenko si prift ka shërbyer në të gjitha familjet e zonës dhe me porosi të tij është varrosur në kodrën Markova Dobica me nëntë priftërinj. Milenko ka dhe lapidarin në Lakaicë me mbishkrimin: "Patriot nacionalist i lindur në fshatin Steblevë."


Nga martesat e Petrushit me Donkën lindën tre djem dhe tri vajza; të gjithë të zgjuar e punëtorë si vetë ai. Gjatë luftës për çlirim e vendit Petro është në fshat me familjen kurse dy djemtë Cvetani dhe Siliani morrën pjesë në luftë. Cvetani, djali më i madh, pasi mbaroi gjimnazin shkoi partizan në brigadën e parë dhe aty lufton deri në çlirim. Pas çlirimit Petro zgjidhet kryetar këshilli i fshatit, pas shumë të tjerëve përpara tij, burra të mençur e të dëgjuar që kanë dhënë mendime të mençura jo vetëm në Steblevë e krahinë, por edhe në kuvende në Dibër.

Në vitin 1932 me disa miq nga fshati shkoi në Sarandë për të punuar si usta, zanat ky i marrë nga dajat e tij mjeshtra të dëgjuar në Selanik. Në Sarandë merret me dekorimet dhe artitekturën në bregun e detit të qytetit. Puna e mirë e pëlqyer nga qytetarët e Sarandës, bëri që usta Petro Gega, siç e thërrisnin banorët e atjeshëm, ta kërkojnë për

Mjeshtri i madh i ndërtimit

PETRUSH ZORBA

(1891-1981)



punë shumë Sarandiotë.

Në grupin e tij të punës ishin Sorbin Cfarku, miku dhe ustai më i mirë, Ongjele Steva, Millosh Shutku, Gjuro Fila etj. këta ishin ustallarë. Kurse për punë voluminoze merrnin punëtorë që ustabashi i trajtonte dhe i paguante mirë. Ata ishin të gatshëm kur t'i kërkoja; -thoshte Petro. Kishim shumë kërkesa për punë. Na kërkonin dhe njerëz me emër e pasuri në Sarandë. Një këta më thotë: "Do të ndërtoj një bina (hotel) të mirë. Paratë i kam vetëm se dua punë të mirë".

Po, - i thotë usta Petro, do të mbetesh i kënaqur. Unë dua të më japësh paratë në çdo muaj, se unë do të marr edhe punëtorë për të përballuar punën".

Po, - shprehet dakord ai, - për këtë të siguroj. Filluam dhe e mbaruam hotelin duke mbetur të kënaqur të dy palët. Kaq besim krijoi pronari tek ustabashi, sa Sorbinin e mori, pasi bisedoi me Petron, për të riparuar dhe dhomën ku mbante paratë. Hoteli që ndërtoan edhe sot e kësaj dite nga vendasit quhet hotel Gega, në nder të ustabashit. Nga Saranda me gjithë brigadën vjen për punë në Durrës tek "Stamlesi" në vitin 1938.

Administratori i shoqërisë "Krahu" na vononte paratë deri në tre muaj. U gjetëm ngushtë, se pa para nuk punonte kush. Ju e shikoni situatën, - u thotë Petro punëtorëve, - kush do të rrijë, mirë; kush nuk do, le të gjejë punë tjetër. Po i mora lekët, do tua jap një për një. Shumë u larguan por mbeti vetëm Sorbin Cfarku, i cili i thotë usta Petros: "ku të vdesin

fëmijët e tu, le të vdesin dhe fëmijët e mi".

Pas çlirimit shkoi me një grup në ndërtimin e Urës së Skurajve. Do të ngriheshin këmbët e urës me hekur e beton. Deri këtu gjithçka shkoi në rregull. Vështirësia ishte në transportimin e shinave nga porti i Durrësit e veçanërisht në montimin e tyre. Koha e përfundimit të urës ishte e përcaktuar. Do të vinte vetë Mehmet Shehu për të parë përfundimin e urës. Në ditën që ai vjen, inxhinieri i ri ishte shumë i shqetësuar pasi përgjegjësia binte mbi të. Usta Petro i thotë: "Ti djalë mos u shqetëso, Mehmet Shehu do ta pres unë e do të flas me të pasi jam takuar dhe më parë e më nejtë". Ashtu bënë. Mehmet Shehu vjen dhe e sheh urën nga larg të papërfunduar. Pa takuar asnjë nga ustallarët pyet: - Pse ska përfunduar ura?!

-Nuk qe e mundur ta përfundojmë, -i drejtohet usta Petro Mehmet Shehut. Me gjithë përpjekjen tonë nuk ishte e mundur, por për katër ditë është gati.

-Ku është inxhinieri që dërguam?

-Ja ku është, por nuk u vonua nga inxhinieri. Ne nuk arritëm të sjellim shinat në kohë, sepse ato ishin të rënda e ne këto mjete kishim, - dhe drejtoni gishtin nga tre pendët e qeve që ishin prapa krahëve të tij. Mirë, -thotë ai, -vazhdoni punën. U drejtohet atyre që e shoqëronin: "Ti jepet këtij titulli Asistent Inxhinier. Aty Petro mori respektin e brigadës e më shumë për qafimin e inxhinierit të ri dhe titullin "Asistent inxhinier".

Në Selitë, kur do të ngrihej hidrocentrali e do të merrte

ujë Tirana, punoi Petro me brigadën e tij ku bënë pjesë Mitre e Stojan Nina, Millosh e Stojan Shutku (dy nipërit e tij), Sorbin Mirçe, Negri Nikolla, Trajçe Mazniku, Gjorçin Steva (dëshmor i punës), Zenel Oshafi, Ajro Kuniqi, Bozhin Traja, Ali Dehari, Zaim Zepa, Qerim Kanxha, Ibrahim Zepa e shumë të tjerë.

Për të kaluar ujin në krahun tjetër të Dajtit duhej hapur tuneli. Kishte shumë vështirësi, pasi mjetet mungonin po kështu edhe përvoja. Këta ustallarë të mençur e të rrahur me vështirësi në punë nuk u tërhoqën edhe pas largimit të specialistëve jugosllavë në verën e vitit 1948. Ata i u vunë punës me zgjuars duke u konsultuar me njëri-tjetrin. Puna duhej filluar në të dy anët malit dhe prandaj duhej precizion në mbajtjen e drejtimit. Në vazhdimin e punës drejtoheshin nga piketat. Në përfundim të punimeve tuneli doli aty ku duhej me një diferencë 10 cm a një pëllëmbë siç thoshte xha Petro e Milloshi.

Suksesi që i madh dhe gëzimi i papërshkrueshëm. Erdhi dhe i përgëzoi për punën e saktë këta mjeshtra drejtori Rahman Hanku, i cili kishte shumë respekt për gollobordasit. Kudo ku kishte ndërtime me probleme, Rahman çonte miqtë e tij që i njihte mirë për aftësitë dhe përkushtimin e tyre në punë.

Në vitet 1967-1968 Petro kthehet në fshatin e tij të dashur Steblevë ku në Graisht pranë "Çorni Kamen" kishte ngritur një shtëpi siç dinte ta bënte ai; në një vend të mrekullueshëm në Bella Rreka, e rrethuar me livadhe dhe më tej me një pyll ahu që të

magjepste me pamjen e tij.

Ai bashkë me djalin e tij Siljanin, ndërtoi një mull për bluarjen e drithit të fshatarëve e që kishte rendiment tre herë më të madh se mullinjtë e tjerë që kishte fshati. Të gjithë fshatarët që bluanin aty thoshin: - "Kjo është fabrikë, jo mulli". Në vitin 1967 banorët e lagjes Sharrë, me iniciativën e xha Petros ngritën një Hec të vogël i cili ndriçoi banorët e lagjes.

Erdhi koha që të dilte në pension por nuk i plotësoheshin vitet për pension të plotë. Xha Petro i drejtohet mikut të tij të vjetër Rahmanit për çështjen e pensionit. Rahman pa një pa dy i thotë: - "Ku do të punosh xha Petro që ta plotësosh pensionin?".

Po, do të punoj, shoku Rahman, ne Vaun e Dejës. Se ju e dini që unë me çentrale jam marrë gjatë gjithë jetës.

Ashtu do të bëhet. Do të punosh atje, se aty ke drejtor mikun tënd Emin Mysliun.

E di, o shoku Rahman, se aty kam brigadier nipin tim Stojanin, dy djemtë e mi dhe tre nipat.

Të të çoj që sot në Vaun e Dejës? , - thotë Rahman.

Jo, unë do të shkoj një herë në shtëpi, dhe pas 1 Majit do të shkoj me djemtë e mi të cilët kanë ardhur për festë.

Megjithëse në moshë të thyer, Petro Zorba i jepte zgjidhje punëve të vështira me përvojën e mençurinë e tij. Kalonte nëpër kantier me një shkop në dorë dhe vështronte punën e punëtorëve. Ku ishte e nevojshme jepte me urtësi ndonjë mendim për kryerjen e punës sa më mirë. Ndalej dhe vështronte me sy dhe thoshte shkurt atë që mendonte. Kudo dëgjohej fjala e tij. Erdhi puna për montimin e transformatorit i cili u bë problem i madh në kantier. Inxhinierët e kantierit nuk po i jepnin zgjidhje. Atëherë, drejtori i kantierit Emin Mysliu i drejtohet brigadës ku punonte Petro Zorba për ti dhënë zgjidhje këtij problemi. Petro së bashku me shokët e tij, pasi vështroi terrenin dhe masën e transformatorit, morrën përsipër që ta çonin transformatorin në bazament.

Transformatori u montua në vendin e caktuar. Të gjithë sa ishin brohoritën dhe duartokitën nga gëzimi. Emin Mysliu, drejtor i kantierit e përqafoi xha Petron dhe i tha: - Mos vdeksh xha Petro! Ti na duhesh gjithmonë. Të paçim!

Për kontributin e dhënë në ndërtimin e shumë veprave të rëndësishme, xha Petros i janë akorduar Urdhrat e Punës të klasit tretë, dytë dhe të parë.

Vitet e fundit xha Petroja i kaloi në fshatin e lindjes. Jetoj mes bashkëfshatarëve të tij, i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë. Në të gjitha dasmat dhe gëzimet familjare atë e vinin në krye të tavolinës. Çdo ditë, shkonte tek klubi i Sharrës ku takonte miq dhe bashkëmoshatarët e tij duke ngritur disa gota vodka. Vetëm kur i vinin miq të largët ai e thyente rregullin prej pesë gotash, dhe për ti respektuar ata ngrinte dhe një tjetër. Dhe pasi merrte dhe një shishe me vete, i udhëhiqte miqtë drejt shtëpisë së tij. Mikpritja ishte e jashtëzakonshme, dhe muhabeti nuk kishte fund.

Kështu e kujtojnë të gjithë xha Petron...

**Fidan Marku
Mitro Shutku
Sokrat Zorba**

Fatmir Brazhda: Stebleva mundësi shumë e mirë për zhvillimin e Ekoturizmit malor



Stebleva si pjesë e rëndësishme e Parkut kombëtar Shebenik-Jabllanicë dalëngadalë po shihet një mundësi shumë e mirë për zhvillimin e turizmit malor,

kjo sipas një politike që po ndjek dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura në Rajonin Elbasan.

Për të mësuar më shumë ne intervistuar Z. Fatmir Brazhda i cili është dhe drejtues i Administratës të Zonave të Mbrojtura në Rajonin e Elbasanit.

Z. Brazhda ?

Duke ju uruar suksese në punën dhe misionin tuaj donim të mësoni më shumë rreth parkut dhe konkretisht për fshatin Stebleve, se si shihet ky fshat në prioritetet e administratës tuaj..??

Në radhë të parë faleminderit që tregoni interes të vazhdueshëm për Steblevën dhe parkun kombëtar Shebenik-Jabllanicë.

Stebleva është një fshat i vogël në skajin Veri-perindimor të parkut kombëtar Shebenik-Jabllanicë, një fshat i njohur në të gjithë vendin për resurset natyrore të pafundme, për vlerat e traditës, kulturës dhe dokmave të vecanta që shoqërohet me mikpritjen bujare, karakteristika model që e bëjnë Steblevën të jetë epiqendra e parkut.

Atraksionet malore nga Raduci, Maja e Zezë, Vishorica, Dragani, Kallkani etj , dhe deri tek lumi i pasur me trofte të egër me pika të kuqe sic i thonë dhe vendasit nuk mjaftojnë ditë të tëra për ti shijuar dhe për ti shkelur ato. Nga një vlerësim i Administratës Rajonale të zonave të mbrojtura Elbasan për potencialet e mundshme eko-turistike Steblevë renditet e para nga të gjitha zonat e tjera.

Cfarë ofron më shumë Stebleva në krahasim me zonat e tjera ?

Shumë e shumë gjëra që vështirë se numërohen , në radhë të parë natyrën e paprekur, pyje te mbrojtur nga të gjithë llojet e drurëve, një pasuri të pafundme të bimësisë, burime ujore të kudogjendura duke përfshirë liqenet akullnajore, faune të pasur me karnivorë të mëdhenj ku mund të përmendim rruqebullin, ariun, ujkun, dhelprën, kaprollin, dhia e eger, derri i eger, lepuri etj.

Pra këto nuk mungojnë dhe kohët e fundit kemi një prani më të madhe falë dhe ligjit për moratoriumin të gjuetisë ku komuniteti i Stebleveës na ka ndihmuar së tepërmi në punën tonë për mbrojtjen e kësaj pasurie nga abuzues të ndryshëm. Stebleva ka turizëm veror po ashtu dhe dimëror. Në verë natyra është e mahnitshme për bukuritë e saj dhe freskinë malit, pyjeve, ujrave duke realizuar dhe guida gjithashtu mund të shijojsh prodhimet bio dhe gatimet tradicionale, ndërsa në dimër mund të shfrytëzohet shumë mirë për ski, hipizëm etj. Pra ka një gamë të gjërë vlerash në funksion të turizmit malor.

Dakord, kemi pasuri të mëdha natyrore por a ka ndonjë përfitim komuniteti ynë nga kjo pasuri ?

Sigurisht që po. Kjo nuk vërehet aktualisht, por që gradualisht shumë shpejt do ta kuptojmë se Stebleva do të jetë një fshat turistik mjaft i frekuentuar, mund



të themi ndoshta edhe më mirë se Dardha e Korçës për faktin se tashmë këtu mund të arrihet më shpejt nga qendrat urbane për shkak se tashmë po ndërtohet dhe rruga, kjo bën të mundur që nga Tirana mund të vijmë për 1 orë e gjysëm maksimumi. Jemi dëshmitarë që trojet për ndërtim

dhe toka në Steblevë nuk shitet ose shitet me çmimet e njëjta si në Tiranë apo Durrës, këtu duket që ka interes të vazhdueshëm dhe në rritje për ndërtime turistike dhe sipërmarrje për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm. Kohët e fundit po vërehet që shumë nga steblevasit që jetojnë në Tiranë

apo qytete tjera po kthehen gjatë beharit dhe po rikonstruojnë dhe ndërtojnë shtëpitë e tyre duke i përshtatur ato për një turizëm malor familjarë.

Ju si administratë e zonave të mbrojtura cfarë keni ne prioritet tuaja për zhvillimin e turizmit në Steblevë dhe në gjithë hapësirën e parkut kombëtar?

Ne si institucion i ri kemi me pak se një vit që kemi filluar punë për menaxhimin e zonave të mbrojtura në varësi të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura pranë Ministrisë Mjedisit dhe menjëherë filluam grumbullimin e informacionit duke u mbështetur dhe në draft planin e menaxhimit të parkut kombëtar. Krahas mbrojtjes dhe monitorimit të vazhdueshëm të resurseve natyrore prioritet i ynë është zhvillimi i ekoturizmit që konkludon në nxitjen dhe promovimin e vlerave që mbart kjo zonë për rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve frekuentues. Gjatë vitit 2015 administrata jonë ka rregjistruar rreth 3000 turistë dhe vizitorë ku rreth 1000 prej tyre kane qenë nga vendet europiane. Kjo gjë na obligon që të marrim masa për përmirësimin e infrastrukturës dhe sinjalistikës në park. Gjatë këtij viti kemi planifikuar të ndërtojmë një qendër informacioni për turistët në Fushë Studen e cila do të jetë një godinë e mjaftueshme për zyrë informacioni e paisur me harta, guida, broshura, etj, po ashtu aty do të ketë një ambient muze me asete etnografike të zonës po ashtu edhe suveniere për turistët. Gjithashtu në këtë qendër do të ketë ambiente dhe për punonjësit e parkut kombëtar. Gjatë vitit 2016 do synojmë të hapim dhe të markojmë me shenja dalluese disa shtigje për guida malore, në të njëjtën kohë do të vendosim tabela treguese prej druri në disa segmente. Festa e parkut kombëtar më 21 Maj përsëri këtë vit do të mbahet në Steblevë duke e bërë atë më të madhe me pjesëmarrje nga të gjitha zonat e tjera të shoqëruar me panairë dhe aktivitet artistike-kulturorë. Ndërsa në të gjithë parkun ku përfshen zona dhe fshatra të tjerë do të ketë shumë aktivitete zhvilluese për parkun. Krahas këtyre prioritetëve ne synojmë të mbështesim dhe banorët e zonave të ndryshme për rritjen e kapaciteteve të tyre për pritjen e turistëve, kryesisht me ndërjegjesime, trajnime dhe mbështetje me miniprojekte zhvilluese.

Cfarë keni ndonjë këshillë apo thirrje për banorët e Steblevës ??

Të jeni krenar që keni një vend shumë të bukur dhe atraktiv, mos e nënvlesoni, mos e harroni, kthehuni dhe investoni sepse guri i rëndë peshon në vendin e tij. Koha do e tregojë që ata që do të zhvillojnë turizmin malor në këtë zonë do të jenë të lumtur dhe njëkohësisht do të trashëgojnë pasuri ekonomike dhe shpirtërore. Natyra e bukur, qetësia, ajri i pastër dhe ushqimet bio janë garanci për një jetë të shëndetshme si për vetë steblevasit ashtu edhe për ata që frekuentojnë për turizëm Steblevën dhe të gjitha zonat në parkun kombëtar Shebenik-Jabllanicë.

Ne jemi të gatshëm t'ju mbështesim për çdo inisiativë që ka si qëllim zhvillimin dhe promovimin e vlerave ekoturistike të parkut kombëtar.

Intervistoi: Mersin HOXHA

Adresa e redakisë: Rruga "Xhon Belushi" Mbas Institutit të Fizikës Bërthamore, Vila Nr 519, Tiranë. Tel. 0695168173.